



Tiranë më	prodate
Nr.	protnumber

RELACION
PËR
PROJEKVENDIMIN
PËR

CAKTIMIN E STRUKTURËS DHE MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR ADMINISTRATËN ZGJEDHORE NË ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Projektvendimi bazohet në dispozitat e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohet kompetenca e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të përcaktuar shpërblimet e anëtarëve të administratës zgjedhore. Dispozitat kryesore që mbështesin këtë vendim janë:

- Neni 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2: Kompetenca për caktimin e strukturës së administratës zgjedhore dhe masës së shpërblimit të saj.
- Neni 29, pika 3: Mundësia për përcaktimin e procedurave dhe kritereve për shpërblim.

Vendimi respekton gjithashtu parimet e proporcionalitetit dhe barazisë, siç parashikohen nga Kodi i Procedurave Administrative dhe legjislacioni në fuqi.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKVENDIMIT

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara është hartuar projektvendimi “Për caktimin e strukturës dhe masës së shpërblimit për administratën zgjedhore në zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë 2025”.

Ky projektvendim ka për qëllim të krijojë një mekanizëm të drejtë, transparent dhe proporcional për shpërblimin e anëtarëve të administratës zgjedhore, duke siguruar motivim dhe barazi për të gjithë zyrtarët e përfshirë në procesin zgjedhor.

Projektvendimi përfshin:

- Përcaktimin e shpërblimit bazë dhe të strukturuar sipas funksioneve dhe përgjegjësi të anëtarëve të KZAZ, të KQV dhe GNV.
- Diferencimin proporcional të shpërblimit të KZAZ-ve bazuar në volumin e qendrave të votimit (QV) dhe vështirësinë gjeografike të zonave të administrimit zgjedhor.
- Ndarjen e shpërblimit të KZAZ-ve sipas fazave të procesit zgjedhor, duke reflektuar intensitetin e punës në secilën fazë.



- Mekanizmat për zëvendësime dhe penalitete, për të siguruar zbatim korrekt të detyrave dhe shmangie të abuzimeve.

1. Shpërblimi bazë dhe struktura sipas funksioneve

Projektvendimi përcakton një shpërblim referencë për anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) në masën 40,000 lekë, duke diferencuar shpërblimet për pozicione të ndryshme:

- Kryetari dhe nënkryetari përfitojnë një shtesë prej 30% mbi shpërblimin bazë, duke reflektuar përgjegjësitë më të larta.
- Sekretari përfiton një shtesë prej 28% mbi shpërblimin bazë, për shkak të detyrave të tij administrative.
- Për KQV dhe GNV janë parashikuar shpërblime të ndryshme, duke reflektuar rolet dhe ngarkesën e punës.

Ky model respekton parimin e barazisë, duke diferencuar shpërblimin në mënyrë proporcionale me përgjegjësitë dhe funksionet e secilit pozicion. Kjo ndarje bazohet në praktikën e deritanishme mbi shpërblimet e administratës zgjedhore, ku diferencimet kanë qënë mbi bazën e diferencimit objektiv.

2. Rritja e shpërblimit bazuar në volumin e QV-ve

Vendimi propozon rritje proporcionale të shpërblimeve të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, bazuar në numrin e QV-ve në juridiksionin e çdo KZAZ:

- 1-20 QV: Shpërblim bazë.
- 21-40 QV: Rritje me 20%.
- 41-60 QV: Rritje me 40%.
- 61-80 QV: Rritje me 60%.
- Mbi 80 QV: Rritje me 80%.

Ky parashikim ndjek standardin e proporcionalitetit, duke lidhur shpërblimin me volumin e punës për secilin juridiksion. Ky diferencim është i nevojshëm për të shmangur trajtimin e pabarabartë të administratës zgjedhore që operon në kushte të ndryshme.

3. Shtesa për vështirësi gjeografike

- Për KZAZ me juridiksion të shtrirë edhe në zona rurale është parashikuar 20% shtesë mbi shpërblimin.
- Për KZAZ me juridiksion vetëm në zona rurale është parashikuar 30% shtesë.

Kjo masë shpërblimi apo bonusi respekton parimin e barazisë së mundësive, duke kompensuar KZAZ-të që përballen me kushte më të vështira gjeografike. Ky komponent bazohet në standarde të njohura ndërkombëtare për punën në zona të vështira.

4. Ndarja e shpërblimit sipas fazave të procesit zgjedhor për Komisionet e Zonave të Administrimit të Zgjedhjeve është parashikuar në këtë vendim të bëhet proporcionalisht:

- 20% për periudhën nga konstituimi deri 40 ditë para zgjedhjeve.
- 40% për periudhën nga 40 ditë deri 2 ditë para zgjedhjeve.
- 40% për periudhën nga 2 ditë para zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultateve.

Kjo ndarje pasqyron ndryshimin në intensitetin dhe dinamikën e punës në secilën fazë, duke siguruar që shpërblimi të jetë në përpjesëtim me ngarkesën faktike të punës. Madje kjo peshë e vlerësimit të punës shërben si një mekanizëm i drejtë për shpërblimin e anëtarëve të KZAZ-ve në rast zëvendësimeve sepse, shpërblimi do të ndahet proporcionalisht me periudhën e angazhimit dhe peshën e punës.

Një risi e këtij vendimi është përcaktimi që anëtarët që emërohen në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenet 29 dhe 33 të Kodit Zgjedhor të humbasin të drejtën për shpërblim nëse nuk ndjekin trajnimet e detyrueshme të organizuara nga KQZ.

Ky mekanizëm synon të parandalojë paligjshmërinë e vendimmarrjeve të KZAZ-ve në emërimin e komisioneve të niveleve të treta, si dhe të nxisë partitë politike që propozojnë anëtarët të nxisin pjesëmarrjen e tyre në këto trajnime, duke siguruar që shpërblimi të lidhet drejtpërdrejt me përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe angazhimin faktik.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim të Komisionerit Shtetëror Zgjedhjeve të projektvendimit “Për caktimin e strukturës dhe masës së shpërblimit për administratën zgjedhore në zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë 2025”.

Erion META

- Drejtoria e Administratës Zgjedhore

Pavlina DOÇAJ

- Drejtoria e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA

- Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

CAKTIMIN E STRUKTURËS DHE MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR
ADMINISTRATËN ZGJEDHORE NË ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN
E SHQIPËRISË 2025

Në mbështetje të nenit 19, pikve 1, shkronja “n”, e 2, nenit 29 pika 3, nenit 36 dhe të nenit 95, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;

VENDOS:

- 1) Të caktojë strukturën dhe masën e shpërblimit për komisionet e zonave të administrimit të zgjedhjeve, nga momenti i konstituimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, bazuar në:
 - (a) Masën referuese të shpërblimit bazë të anëtarit;
 - (b) Strukturën e shpërblimit sipas përgjegjësisë;
 - (c) Rritjen proporcionale të shpërblimit bazuar në volumin e qendrave të votimit;
 - (d) Shtesën për vështirësi bazuar në komponentin gjeografik
 - (e) Marrjen e shpërblimit në proporcion me praninë në mbledhje dhe në proporcion me ngarkesën e punës.
- 2) Shpërblimi për anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), nga momenti i konstituimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve bazohet në një shpërblim referencë prej 40,000 (dyzetë mijë) lekë për anëtar.
 - a) Sekretari do të shpërblehet me 28% më shumë se masa e shpërblimit bazë të anëtarit.
 - b) Kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së do të shpërblehet me 30% më shumë se masa e shpërblimit bazë të anëtarit.
- 3) Rritja proporcionale e shpërblimit bazuar në volumin e qendrave të votimit (QV) do të jetë:
 - a) Për KZAZ me 1-20 qendra votimi (QV), do të aplikohet shpërblimi bazë;
 - b) Për KZAZ me 21-40 QV, do të aplikohet një rritje prej 20% mbi shpërblimin bazë për secilin pozicion;
 - c) Për KZAZ me 41-60 QV, do të aplikohet një rritje prej 40% mbi shpërblimin bazë për secilin pozicion;
 - d) Për KZAZ me 61-80 QV, do të aplikohet një rritje prej 60% mbi shpërblimin bazë për secilin pozicion;
 - e) Për KZAZ me mbi 80 QV, do të aplikohet një rritje prej 80% mbi shpërblimin bazë për secilin pozicion.

Data: dd mm vvvv Nr:
Ora: hh:mm



Për caktimin e strukturës dhe masës së shpërblimit për administratën zgjedhore në zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë 2025

- 4) Shtesa bazuar në vështirësi për komponentin gjeografik do të jetë:
 - a) Për KZAZ juridiksioni i të cilave është i shtrirë edhe në zona rurale do të jetë 20% e masës së shpërblimit sipas pikave 1 dhe 3 të këtij vendimi;
 - b) Për KZAZ-të juridiksioni i të cilave është tërësisht në zona rurale do të jetë 30% e masës së shpërblimit sipas pikave 1 dhe 3 të këtij vendimi.
- 5) Shpërblimi për anëtarët dhe sekretarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) të bëhet në proporcion me peshën e ngarkesës së punës për ushtrimin të detyrave dhe praninë e tyre në mbledhje sipas skemës së mëposhtme:
 - a) 20% e punës do të vlerësohet nga momenti i konstituimit të KZAZ-së deri 40 ditë para ditës së zgjedhjeve.
 - b) 40% e punës do të vlerësohet nga 40 ditë deri 2 ditë para ditës së zgjedhjeve.
 - c) 40% e punës do të vlerësohet deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.
- 6) Komisioni i qendrës së votimit përfiton shpërblim sipas funksionit dhe përgjegjësi që ushtrojnë si vijon:
 - a) Kryetari i Komisionit të Qendrës së Votimit (KQV) shpërblehet në vlerën 4.000 (katër mijë) lekë.
 - b) Anëtari dhe Sekretari i KQV-së shpërblehet në vlerën 3.500 (tre mijë e pesëqind) lekë.
- 7) Anëtari i Grupit të Numërimit të Votave (GNV) shpërblehet në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) lekë.
- 8) Anëtarët që emërohen kryesisht nga KQZ dhe KZAZ për plotësimin e vakancave dhe ruajtjen e kuorumit të nevojshëm në KZAZ dhe KQV, në përlllogaritjen e masës së shpërblimit bazë sipas përcaktimeve të pikës 2 dhe 6 të këtij neni, bëhet:
 - a) në masën 76,000 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lek për anëtarët e KZAZ-së
 - b) në masën 10,000 (dhjetë mijë) lek për kryetarin/ anëtarin/ sekretarin e KQV-së.
- 9) Pagesa e administratës zgjedhore kryhet mbi bazën e listës së prezencës të paraqitur nga KZAZ në KQZ, në përpjesëtim me ditët e pjesëmarrjes së tyre në mbledhje.
 - a) Për anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së pagesa bëhet në përputhje me listprezencën dhe peshën sipas pikës 5 të këtij vendimi.
 - b) Në rast të zëvendësimeve, shpërblimi ndahet ndërmjet anëtarëve që kanë kontribuar në proporcion me periudhën e angazhimit dhe peshën e ngarkesës së punës të përcaktuara në këtë vendim.
 - c) Pagesa e anëtarëve të KQV-ve dhe GNV-ve realizohet në bazë të listës së prezencës të konfirmuar nga kryetari dhe sekretari i QV-së dhe më pas nga KZAZ-ja përkatëse.
- 10) Anëtarët e administratës zgjedhore humbasin të drejtën për shpërblim nëse nuk ndjekin trajnimet e detyrueshme të organizuara nga KQZ-ja.
- 11) Përpara emërimit dhe hartimit të listë-pagesave, KZAZ-ja verifikon pjesëmarrjen në trajnime të anëtarëve të KQV-ve dhe GNV-ve dhe certifikimin e tyre nga KQZ.
- 12) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 13) Ky vendim mund të ankimohet pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI